

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E HENE 2 TETOR 2023

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Si fillim gjej rastin t'u uroj shumë suksese 121 000 studentëve që filluan sot vitin e ri akademik! Mbi të gjitha, vëmendja është tek ata studentë të Mjekësisë, të cilët nuk e filluan sot vitin e ri akademik, por e bojkotuan atë, sepse kjo qeveri miratoi me forcën e kartonit një ligj antikushtetues dhe antikombëtar. Të nderuar kolegë, a e dini se familjet shqiptare sot e kanë shumë të vështirë të dërgojnë në auditorë fëmijët e tyre, pasi e kanë të pamundur të përballojnë shpenzimet kolosale që çdo student bën çdo ditë apo çdo fund muaji? A e dini që shumica prej tyre marrin kredi për të përballuar shpenzimet? A e dini me sa janë rritur qiratë e apartamenteve në Tiranë? Çfarë u mundëson ky shtet inekzistent studentëve? Ata kanë zero mbështetje dhe përkrahje nga shteti. Secili prej tyre ka bërë shumë sakrifica dhe gjatë gjithë verës ka punuar për të siguruar pagesën e qirasë në Tiranë. Krahas studimeve, shumë prej tyre edhe punojnë. Ndaj, unë dua t'u uroj edhe një herë shumë suksese! Zoti ju ruajt, sepse kjo qeveri nuk e ka vëmendjen te ju, por te kanabisi, korrupsioni dhe lojërat e fatit! Tani dua të flas pak për qarkun e Lezhës, që unë përfaqësoj, i cili, në fakt, është një ndër qarqet me varfërinë më të madhe në të gjithë Shqipërinë. Edhe pse ka një territor shumë të favorshëm për zhvillim ekonomik dhe turistik, situata ekonomike për mijëra familje që jetojnë në atë qark, është shumë e vështirë. Qeveria dhe pushteti absolut i "Rilindjes" kanë dështuar në studimin e faktorëve dhe hartimin e politikave që ndikojnë në uljen e varfërisë dhe rritjen e mirëqenies së familjeve shqiptare. Sot që flasim, qarku i Lezhës ka probleme të mprehta në kushtet e jetesës.

Qindra familje jetojnë në kushte shumë të vështira në Ungrej, Kashnjet, Zadrimë, Torovicë, Bregun e Matit dhe kudo tjetër. Pushteti juaj, i bërë njësh me ngjyrën e partisë, nuk e njeh realitetin ulëritës, që shpeshherë e përshkruani bukur nga Tirana, ndërkohë që gjendja në të vërtetë është alarmante. Për shkak të mosmbështetjes së bujqësisë, mijëra hektarë tokë në fushat e Lezhës janë lënë djerrë. Një kilogram grurë është shitur me 25-30 lekë dhe po aq shitet sot edhe një kilogram misër. Bujqësinë po e falimentoni dhe bashkë me të edhe blegtorinë. Këta janë dy sektorë shumë të rëndësishëm, që Lezhës dhe mbarë vendit po i shkaktojnë pasoja të rënda, sepse 60% e popullsisë së Lezhës jeton në fshat. Ata merren me bujqësi dhe blegtori, por mungesa e subvencioneve dhe e mbështetjes janë arsyeja e shpopullimit dhe braktisjes së fshatrave të Lezhës. Njerëzit ikin nga fshati, sepse nuk kanë as kushtet më minimale të jetesës: po mbyllen shkolla, kopshte, dalin mësues pa punë, duke i shkaktuar Shqipërisë një dëm të madh dhe të parikuperueshëm; emigrim masiv të popullsisë deri në shpopullim të fshatrave dhe qyteteve të tëra. Ju në Tiranë nuk e shikoni kështu situatën dhe mund të mendoni që unë po bëj politikë, por, në fakt, ky është një realitet i trishtë, të cilin me dhimbje po jua përsëris: po zhbëhen fshatra të tëra, qytete të tëra, po mbyllen shkolla, po mbyllen kopshte, ka më pak studentë çdo vit në auditorë, po mbillet gjithmonë e më pak sipërfaqe toke dhe shumë zona po përjetojnë varfëri ekstreme. Përballë këtij realiteti të trishtë, ju mburreni se po rrisni pensionet e 767 000 pensionistëve. A ka tallje më të madhe për pensionistët? Është tallje dhe arrogancë, vlera të cilat ju i trumbetoni me kaq zhurmë. Në të vërtetë, buxheti që ju menaxhoni, të cilin, në fakt, e keqmenaxhoni, ka fuqi të shpërndajë miliona euro për inceneratorët fantazmë, por vetëm 500 lekë të vjetër në ditë për një pensionist. Pra, as një kafe në ditë nuk po u jepni apo më mirë të themi, është lëmoshë që po u jepni pensionistëve. Ndërkohë, një litër naftë kushton 2 000 lekë, një kilogram domate kushton 1 800 lekë dhe një kilogram djathë kushton deri në 14 000 lekë.

Imagjinoni mijëra pensionistë, të cilët me këtë rritje skandaloze të pensionit duhet të përballojnë rritjen me 40-50% të çmimeve të shportës, duhet të përballojnë çmimet e ilaçeve, duhet të paguajnë gazin, duhet të paguajnë faturat e kripura të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, por, mbi të gjitha, duhet të mbijetojnë. A mund të më thoni sa ju vlen kjo vlerë kaq e vogël, kjo lëmoshë që qeveria po u jep atyre? Po të mos ishin emigrantët, sot pensionistët në Shqipëri do të vdisnin për kafshatën thatë të bukës së gojës. Thënë shqip: braktisje dhe lënie në mëshirë të fatit, asgjë më shumë.

Faleminderit!